

# FAQ

## UDHËRRËFYESI TURISTIK

### **1. Udhërrëfyesit e pajisur me një certifikatë paraprake do të futen në procesin e rinovimit të certifikatës së udhërrëfyesit turistik?**

Jo. Sipas pikës 3 të nenit 4 të udhëzimit të përbashkët nr. 517, datë 24.01.2017, “Për akreditimin e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik dhe miratimin e krediteve minimale të programit për edukimin profesional në vazhdim”, deri më tani udhërrëfyesit që kishin përfunduar me sukses të paktën 60% të krediteve nga secila fushë e programit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik, u pajisën me certifikatë paraprake deri në përmbushjen nga ana e udhërrëfyesit turistik të të gjitha moduleve të programit të miratuar.

Sipas pikës 4 të nenit 4 pas përfundimit të të gjitha moduleve të programit të kualifikimit, subjekti do të pajiset me certifikatën e udhërrëfyesit sipas nenit 57 të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar.

### **2. Si do të realizohet përmbushja e moduleve të programit të miratuar për t’u pajisur me certifikatën e udhërrëfyesit sipas nenit 57 të ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar.**

Udhërrëfyesit turistik të pajisur me certifikatë paraprake, duhet të paraqiten pranë subjekteve që ofrojnë programet e akredituara të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik të miratuara nga ministria përgjegjëse për turizmin dhe ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, për të përmbushur të gjitha modulet e plotësuar kreditet e mbetur të programit të miratuar.

### **3. Si është kryer njohja e krediteve për pajisjen me certifikatë paraprake?**

Sipas pikës 2 të nenit 4, programet e kualifikimit të udhërrëfyesit turistik që janë përfunduar me sukses nga udhërrëfyesi turistik para hyrjes në fuqi të udhëzimit janë njohur nga Komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike, i ngritur me urdhër të Ministrit përgjegjës për turizmin, në bazë të dokumenteve të paraqitura, për modulet përkatëse që përkojnë me modulet e programit sipas Aneksive nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 dhe pas kalimit të një testimi të udhërrëfyesit lidhur me modulet e programit të kualifikimit.

Individët të cilët janë pajisur me certifikatë paraprake mund të dërgojnë email në [info@turizmi.gov.al](mailto:info@turizmi.gov.al) që të informohen në lidhje me kreditet e përfituara nëse nuk i kanë.

#### **4. Cilat janë programet e kualifikimit për udhërrëfyesit turistik, të akredituara dhe subjektet që i ofrojnë ato?**

1. Programi i kualifikimit të udhërrëfyesit turistik Kombëtar, i cili ofrohet nga:

- 1.1 Tirana Training Center
- 1.2 NATGA Training Center
- 1.3 Pegasos Travel

2. Programi i kualifikimit të udhërrëfyesit turistik Lokal, i cili ofrohet nga:

- 2.1 Tirana Training Center
- 2.2 NATGA Training Center

3. Programi i kualifikimit të udhërrëfyesit turistik Specialiteti i Veçantë- Rafting/Kajak dhe Kanoe/ Hidrospeed/ Kanionim dhe Kacavjerrje, të cilët ofrohen nga:

- 3.1 Federata Shqiptare e Rafting

Gjithashtu sqarojmë se institucione të arsimit të mesëm profesional dhe të arsimit të lartë, programet e të cilëve përmbajnë kërkesat minimale për trajnimin e udhërrëfyesve turistikë dhe programet përkatëse të kualifikimit sipas aneksit nr.1, nr.2, dhe nr.3, të Udhëzimit të përbashkët nr. 517, datë 24.01.2017, “Për akreditimin e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik dhe miratimin e krediteve minimale të programit për edukimin profesional në vazhdim” janë:

1. Programi i kualifikimit të udhërrëfyesit turistik Kombëtar, i cili ofrohet nga:

- a. SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”

2. Programi i kualifikimit të udhërrëfyesit turistik Specialiteti i Veçantë- Hiking dhe Trekking/Scuba Diving/Ski touring dhe ski Shoeing/Stand up Paddle/Biking tours/Off Road, Kayak në det dhe liqen të cilët ofrohen nga:

- a. SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”

3. Programi i kualifikimit të udhërrëfyesit turistik Specialiteti i Veçantë- Stand up Paddle, Kayak, Scuba Diving, Hiking, Trekking, Biking, Climbing, Ski, Ski touring, Shtegëtim me raketa bore, Off Road, Rafting të cilët ofrohen nga:

- a. Universiteti Sporteve të Tiranës

#### **5. A njihet të nxënit e mëparshëm nga subjektet që ofrojnë programet e kualifikimit të akredituara?**

Sipas pikës 1 të nenit 4, subjektet që ofrojnë programe të akredituara për kualifikimin e udhërrëfyesit turistik njihin të nxënit e mëparshëm, informal dhe formal, të dokumentuar të kursanteve dhe i japin atyre përjashtim nga detyrimi për të ndjekur module specifike të programit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik në bazë individuale. Modulet e përjashtuara pas njohjes së të nxënit të

mëparshëm të kursantit do të konsiderohen se janë përfunduar sipas programit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik që ofron subjekti.

Subjektet që ofrojnë programe të akredituara për kualifikimin e udhërrëfyesit turistik kanë detyrimin të përjashtojnë ndjekjen e moduleve të njohura nga Komisioni i Standardizimit të veprimtarive turistike.

#### **6. Cilët janë elementët e certifikatës me të cilën pajiset kursantin pas përfundimit të kursit?**

- a. Emërtimi (Certifikatë);
- b. Nr. Amze (referuar librit të amzës);
- c. Emri i subjektit sipas emërimit në liçensën e QKL-së
- d. Foto e kursantit e prekur nga vula e subjektit
- e. Teksti të përmbajë të dhënat e shënuara në librin e amzës
- f. Numri i plotë i liçensës dhe data e liçensimit, dhënë nga QKL-ja;
- g. Emri i administratorit, firma dhe vula e subjektit”.

Kjo certifikatë shoqërohet edhe me programin ku përcaktohen kreditet e fituara.

#### **7. Cili është institucioni që kryen certifikimin e udhërrëfyesit turistik?**

Sipas pikës 3 të nenit 57 të ligjit 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar ministria përgjegjëse për turizmin lëshon certifikatën e udhërrëfyesit turistik për kategorinë dhe gjuhën përkatëse të udhërrëfyesit.

#### **8. Ku regjistrohet certifikata e udhërrëfyesit turistik?**

Sipas pikës 3 të nenit 57 të ligjit 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, certifikata që miraton kryerjen e shërbimit të udhërrëfyesit turistik regjistrohet në Regjistrin Qendror të Turizmit, që administrohet nga struktura përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.

#### **9. Ku dorëzohet kërkesa për pajisjen me certifikatë të udhërrëfyesit turistik?**

Sipas VKM nr. sipas VKM nr. 692, datë 05.10.2016 “Për miratimin e rregullores “Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre”, për t'u pajisur me certifikatën e udhërrëfyesit turistik, aplikuesi duhet të dorëzojë pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin kërkesën me shkrim.

#### **10. Çfarë përmban kërkesa me shkrim?**

Sipas VKM nr. 692, datë 05.10.2016 “Për miratimin e rregullores “Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre”, kërkesa me shkrim përmban:

- a. të dhënat e aplikuesit (emrin, mbiemrin, numrin personal, adresën e saktë, numrin e telefonit);
- b. kategorinë e udhërrëfyesit turistik, për të cilën kërkohet certifikata;
- c. gjuhën ose gjuhët e huaja në të cilën udhërrëfyesi do të ushtrojë aktivitetin e tij;
- d. vendin, datën dhe nënshkrimin e aplikuesit.

### **11. Cilat janë kriteret për certifikimin e udhërrëfyesit turistik?**

Sipas VKM nr. 692, datë 05.10.2016 “Për miratimin e rregullores “Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre”, personi, i cili do të pajiset me certifikatën e udhërrëfyesit turistik duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a) Të jetë mbi moshën 18 vjec;
- b) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- c) Të mos ketë qenë i dënuar me heqje lirie për vepra penale të kryera me dashje;
- d) Të jetë i pajisur me dokumentin që vërteton përfundimin me sukses të programit/përkatës të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik, sipas kategorive dhe programeve të akredituara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.93/2015, "Për Turizmin", i ndryshuar.

### **12. Shtetasit e huaj çfarë kriteresh duhet të plotësojnë për certifikim?**

Në rastin e një shtetasi të huaj, sipas VKM nr. 692, datë 05.10.2016 “Për miratimin e rregullores “Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre”, përveç plotësimit të kriterëve të përmendura në pyetjen 11, ai duhet:

- a. të jetë me qëndrim të ligjshëm, për jo më pak se një vit, në Republikën e Shqipërisë
- b. të ketë njohuri bazë të gjuhës shqipe.

### **13. Përveç kërkesës, çfarë dokumentacioni tjetër duhet të dorëzohet?**

Sipas VKM nr. 692, datë 05.10.2016 “Për miratimin e rregullores “Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre”, kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a) Fotokopjen e letërnjoftimit ose pasaportës;
- b) Dëshminë e penalitetit, të leshuar jo më herët se tre muaj përpara datës së aplikimit, e cila mund të paraqitet origjinale ose fotokopje e noterizuar;

- c) Fotokopjen e noterizuar të dokumentit të përfundimit të studimeve të arsimit të mesëm ose të lartë;
- d) Fotokopjen e noterizuar të dokumentit që vërteton përfundimin me sukses të programit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik, sipas kategorisë përkatëse;
- e) Fotokopjen e noterizuar të dokumentit që vërteton njohjen dhe aftësitë komunikuese shumë të mira në gjuhën e huaj, në të cilën do të ofrojë shërbimet e tij udhërrëfyesi turistik. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj duhet të jetë të paktën i nivelit B2, sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët.
- f) Vërtetimin për pagesën e tarifës së aplikimit, sipas pikës 1, të nenit 11 të VKM nr. 692, datë 05.10.2016.

#### **14. A ka dokumentacion shtesë për shtetasit e huaj?**

Sipas VKM nr. 692, datë 05.10.2016 “Për miratimin e rregullores “Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre”, për shtetasit e huaj, përveç dokumenteve të përmendura në pyetjen 13, kërkesa duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Leje qendrimi e shtetasit të huaj në Republikën e Shqipërisë, e vlefshme për jo më pak se një vit;
- b) Dokument (certifikatë/dëshmi) që vërteton njohuritë bazë të gjuhës shqipe, të lëshuar nga një institucion i certifikuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.

#### **15. Për sa kohë është e vlefshme certifikata e udhërrëfyesit turistik?**

Sipas ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar dhe VKM nr. 692, datë 05.10.2016 “Për miratimin e rregullores “Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre”, afati i vlefshmërisë së certifikatës së udhërrëfyesit turistik është 2 vjet nga data e lëshimit, me të drejtë rinovimi.

#### **16. Me çfarë dokumentacioni pajiset udhërrëfyesi turistik pas certifikimit të tij?**

Sipas ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin” i ndryshuar, udhërrëfyesi turistik pajiset me certifikatën e udhërrëfyesit turistik dhe me dokumentin identifikues zyrtar.

#### **17. Çfarë përmban certifikata e udhërrëfyesit turistik?**

Sipas ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin” i ndryshuar dhe VKM nr. 692, datë 05.10.2016 “Për miratimin e rregullores “Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre”, Certifikata e udhërrëfyesit turistik përmban:

- a) emrin dhe mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes, adresën e udhërrëfyesit turistik;
- b) kategorinë e udhërrëfyesit turistik;
- c) territorin ku do të ushtrojë veprimtarinë si udhërrëfyes turistik, sipas kategorisë përkatëse;
- ç) gjuhën në të cilën ai do të ushtrojë veprimtarinë si udhërrëfyes turistik;
- d) datën e lëshimit të certifikatës.

### **18. Çfarë përmban dokumenti identifikues?**

Sipas ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar dokumenti identifikues përmban të njëjtat të dhëna si certifikata e udhërrëfyesit turistik.

Sipas pikës 2 të nenit 58 të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar udhërrëfyesi turistik duhet ta mbajë dokumentin identifikues zyrtar në një vend të dukshëm të veshjes së vet, gjatë gjithë kohës që kryen shërbimet si udhërrëfyes turistik.

### **19. A parashikohen kundrvajtje administrative?**

Sipas nenit 71 të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e mëposhtme janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë:

1. Ushtrimi i veprimtarisë pa certifikatë, sipas pikës 1, të nenit 57, të ligjit 93/2015 “Për Turizmin” dënohet me gjobë 100 000 lekë.
2. Ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesën e përcaktuar në pikën 2, të nenit 58, të ligjit 93/2015 “Për Turizmin”, dënohet me gjobë 50 000 lekë.
3. Ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 61 të ligjit 93/2015 “Për Turizmin”, dënohet me gjobë 150 000 lekë. Në pikën 1 të nenit 61 parashikohet se: Udhërrëfyesi turistik i huaj, i cili nuk është i certifikuar në Republikën e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, mund të shoqërojë grupe vizitorësh apo turistësh të huaj, për qëllime turistike, në territorin e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e shoqëruesit të udhëtimit. Ai duhet të ketë si shoqërues një udhërrëfyes turistik të certifikuar, sipas parashikimeve të këtij ligji, në bazë të një kontrate shërbimi, i cili duhet të jetë prezent gjatë vizitës të grupit të huaj në territorin shqiptar,

### **20. Cili është institucioni që ushtron kontroll për subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike?**

Sipas ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, Inspektorati që mbulon fushën e turizmit kontrollon zbatimin e kriterëve dhe kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e ligjit 93/2015 “Për Turizmin”, akteve nënligjore në zbatim të tij dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

## **21. Por për subjektet kërkuese që ofrojnë programet e akredituara të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik, a ushtrohet kontroll?**

Sipas pikës 7 të nenit 6 të udhëzimit të përbashkët nr. 517, datë 24.01.2017, “Për akreditimin e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik dhe miratimin e krediteve minimale të programit për edukimin profesional në vazhdim”, përgjatë periudhës së vlefshmërisë së akreditimit, subjektet kontrollohen të paktën një herë në vit për vazhdimësinë e përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim dhe rekomandimeve të dhëna në raport. Në rast të verifikimit të mangësive të konsiderueshme, të cilat sipas mendimit të Komisionit të Akreditimit, nuk mund të ndreqen shpejt ose lehtësisht, i propozohet ministrave përgjegjës, tërheqja e akreditimit.

## **22. Çfarë kushtesh duhet të plotësohen për rinovim të certifikatës së udhërrëfyesit turistik?**

Sipas VKM nr. 692, datë 05.10.2016 “Për miratimin e rregullores “Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre” të gjithë udhërrëfyesit për rinovimin e certifikatës së udhërrëfyesit turistik, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) Të mos ketë qenë i dënuar me heqje lirie për vepra penale të kryera me dashje.
- b) Të ketë ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje;
- c) Të ketë marrë kreditet e nevojshme për rinovim, në bazë të sistemit të krediteve të programit për edukimin profesional në vazhdim, sipas ligjit nr.93/2015, "Për Turizmin", i ndryshuar.

## **23. A duhet të paraqes kërkësë për rinovim të certifikatës së udhërrëfyesit turistik?**

Sipas VKM nr. 692, datë 05.10.2016 “Për miratimin e rregullores “Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre”, udhërrëfyesi, jo më vonë se 30 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë prej 2 vitesh të certifikatës së tij, paraqet kërkesën me shkrim për rinovimin e certifikatës, në përmbajtje e të cilës ka:

- a) të dhënat e aplikuesit (emrin, mbiemrin, numrin personal, adresën e saktë, numrin e telefonit);
- b) kategorinë e udhërrëfyesit turistik, për të cilën kërkohet certifikata;
- c) gjuhën ose gjuhët e huaja në të cilën udhërrëfyesi do të ushtrojë aktivitetin e tij; vendin, datën dhe nënshkrimin e aplikuesit.

## **24. Çfarë dokumentacioni duhet të dorëzohet për rinovim të certifikatës së udhërrëfyesit turistik?**

Sipas VKM nr. 692, datë 05.10.2016 kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin:

- a) Fotokopje e letërnjoftimit ose pasaportës;
- b) Fotokopje e certifikatës së vlefshme të udhërrëfyesit;
- c) Fotokopje e noterizuar e dokumentacionit që provon marrjen e krediteve të nevojshme për rinovim, sipas kërkesave të ligjit nr. 93/2015, “Për Turizmin”, i ndryshuar.

Vërtetimi për plotësimin e niveleve minimale të krediteve provohet me dorëzimin e:

i. Certifikata pjesëmarrje, vërtetime apo dokumenta të ngjashme me to, të lëshuara nga subjektet organizatore, që vërtetojnë pjesëmarrjen e personit të interesuar, tematiken e aktivitetit e përshtatshme për veprimtarinë e udhërrëfyesit turistik sipas kategorisë përkatëse, dhe kohëzgjatjen e aktivitetit, (20 orë) në lidhje me formën "Në kontakt";

ii. Kontrata shërbimi dhe vërtetime pune shoqëruar më deklaratën e sigurimeve shoqërore (192 orë pune) në lidhje me formën "Në praktikë".

- d) Dëshminë e penalitetit, të lëshuar jo më herët se tre muaj përpara datës së aplikimit, dhe mund të paraqitet origjinale ose fotokopje e noterizuar;
- e) Vërtetimi për pagesën e tarifës së aplikimit, sipas pikës 1, të nenit 11.

## **25. A ka dokumentacion shtesë për shtetasit e huaj për rinovim të certifikatës së udhërrëfyesit turistik?**

Sipas VKM nr. 692, datë 05.10.2016 për shtetasit e huaj, përveç dokumenteve të parashikuara më sipër, kërkesa duhet të shoqërohet edhe me lejen e qëndrimit të shtetasit të huaj në Republikën e Shqipërisë, të rinovuar.